

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Shkenca Politike
<b>Titulli i lëndës:</b>	Politika Krahasimore e vendeve të Ballkanit
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	II-III
<b>Numri i orëve në javë:</b>	3+2
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	7
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Anton Vukpalaj
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:Anton.vukpalaj@uni-pr.edu">Anton.vukpalaj@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Kjo lëndë bazohet në një analizë të sistemeve politike dhe administrative të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, lënda do të analizojë tranzicionin politik dhe konsolidimin e demokracisë në këto vende. Kjo për të kuptuar më mirë evolucionin e ndryshëm të këtyre vendeve, 20 vjet pas rënies së komunizmit. Objektivi është të kuptohen çështjet strukturore, institucionale dhe politike që kanë bërë që disa nga këto vende të përparojnë drejt demokratizimit dhe sot janë pjesë e Bashkimit Evropian dhe NATO-s (Sllovenia, Kroacia), ndërsa të tjerat kanë ngecur dhe madje kanë dështuar deri tani në ndërtimin e sistemeve politike të qëndrueshme.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i kësaj lënde është të përgatisë studentët për reflektim kritik mbi realitetin e shteteve të Ballkanit. Në përgjithësi, lënda shërben si një hyrje për ata që kanë pak njohuri për historinë, institucionet, politikën dhe strukturën sociale të shteteve të Ballkanit Perëndimor.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të lëndës, studentët duhet të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> <li>- të kenë një pasqyrë të gjerë të zhvillimeve kryesore historike në politikën e vendeve ballkanike;</li> <li>- të përmirësojnë kuptimin e metodës krahasuese në studimin e politikës ballkanike;</li> <li>- të jenë në gjendje të kryejnë kërkime për Ballkanin duke përdorur metodën e politikës krahasuese;</li> <li>- t'u japë studentëve njohuri për vende të veçanta të Ballkanit;</li> <li>- t'i inkurajojë studentët të zhvillojnë një vlerësim kritik të avantazheve dhe disavantazheve të teorive, koncepteve dhe kategorive të shkencave politike kur zbatohen në studimin e Ballkanit.</li> </ul>
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ramet Sabrina Petra, <i>Central and Southeast European Politics since 1989</i>, Cambridge, Cambridge University Press 2010.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Chandler, D. <i>Bosnia: Faking Democracy After Dayton</i>, Pluto Press, 2000.</li> <li>• G. Ekiert and S. Hanson, eds., <i>Capitalism and Democracy in Central and Eastern Europe</i>, Cambridge University Press 2003.</li> <li>• Mazower, M. <i>The Balkans. A Short History</i>, New York: Modern Library, 2002.</li> <li>• Banac, I. <i>The National Question in Yugoslavia. Origins, History, Politics</i>, London, Cornell University Press 1994.</li> <li>• Bieber, F. “Patterns of competitive authoritarianism in the Western Balkans”, <i>East European Politics</i>, Vol. 34, 2018-issue 3.</li> <li>• Gallagher Th. “The Balkans since 1989: The Winding Retreat from National Communism,” pp. 74-89, in: White, S. Batt, J. and Lewis, P. <i>Developments in Central and East European Politics 3</i>. London, Palgrave, 2003.</li> <li>• Kasapovic, M. “Bosnia and Herzegovina: Consociational or Liberal Democracy?”, <i>Croatian Journal of Political Science</i>, Vol. XLII (2005), No. pp. 3-30.</li> <li>• Krastev, I. “The Balkans: Democracy without choices”, <i>Journal of Democracy</i>, Vol. 13. No. 3, 2002, pp. 39-53.</li> <li>• Pridham G. “Democratisation in Central and Eastern Europe: A Comparative Perspective” pp. 269-290, in: White, S. Batt, J. and Lewis, P. <i>Developments in Central and East European Politics 3</i>. London, Palgrave, 2003.</li> <li>• Stojarova V. and Emerson P., <i>Party Politics in the Western Balkans</i>, London, Routledge, 2010.</li> </ul> <p style="text-align: center;">-</p>
<p><b>Literatura shitesë:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Steven Levitsky and Lucan A. Way, <i>Competitive Authoritarianism: Hybrid Regimes After the Cold War</i>, Cambridge University Press, 2010.</li> <li>• Susan L. Woodward. <i>Balkan Tragedy: Chaos and Dissolution after the Cold War</i>. Brookings Institution, 1995.</li> <li>• Philip G. Roeder, <i>Where Nation-States Come From? Institutional Change in the</i></li> </ul>

*Age of Nationalism*, Princeton University Press, 2007.

**Plani i dizajnuar i mësimit:**

<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e pare : Hyrje</i>	Hyrje dhe diskutim mbi sillabusin e lëndës
<i>Java e dytë: Ballkani Perëndimor dhe politika ndërkombëtare</i>	Importimi i modeleve shtetërore dhe pasojat në shtetformim;
<i>Java e tretë: shtetet e Ballkanit dhe sovraniteti</i>	Mbi sovranitetin negativ dhe sovranitetin pozitiv (Robert Jackson); Heterogjeneiteti i shteteve të lindura në territorin e ish-Jugosllavisë;
<i>Java e katërt : tensionet identitare</i>	Refuzimi i modelit politik perëndimor; strategjitë kulturore; aktivizmi populist;
<i>Java e pestë: nacionalizmi</i>	Kuadri stato-nacionalist ; Koncepti kontraktualist i shtetit;
<i>Java e gjashtë: nacionalizmi II</i>	Kushtet e emergjencës së perspektivës së nacionalizmave;
<i>Java e shtatë:</i>	Testi gjysëmsemestrial
<i>Java e tetë: sistemet politike</i>	Krahasimi i sistemeve politike të vendeve të Ballkanit: Shqipëria, Kroacia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi
<i>Java e nëntë: përfaqësimi politik</i>	Partitë politike ; Periudha postkomuniste; shumëpartiake; Monopoli i partive politike;
<i>Java e dhjetë: Krahasim i sistemet zgjellore</i>	Përbërësit kryesorë të sistemeve zgjedhore të shteteve ballkanike: format e kandidimit, metodat e votimit, njësitë zgjedhore, metodat e shndërrimit të votave në mandate etj.
<i>Java e njëmbëdhjetë: krahasim i legjislativit</i>	parlamentet njëdhomësh dhe dydhomësh; Pesha e parlamenteve në sistemin politik në Ballkan; Modele të ndryshme;
<i>Java e dymbëdhjetë: Krahasim i sistemeve të drejtësisë</i>	Drejtësia: politikat e drejtësisë, tribunalet;
<i>Java e trembëdhjetë: Pakicat kombëtare</i>	Përfaqësimi i pakicave në sistemin politik; Legjislacioni për pakicat kombëtare; Tipologjitë;
<i>Java e katërbëdhjetë: BE-ja dhe Ballkani</i>	Integrimi (ose jo) në Bashkimin Evropian dhe në institucionet ndërkombëtare
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kollokviumi i dytë

**Politikat akademike dhe rregullat e sjelljes:**

Të gjitha sipas statutit të UP-së.